



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 2153/1 Prot.

Tiranë më 31.07.2023

Lënda: Afatet për kryerjen e lëvizjeve paralele 2023.

**DREJTORIVE RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
ZYRAVE VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në zbatim të Udhëzimit Nr.17, dt.26.07.2023, "Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin Nr.12, datë 10.06.2021 "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë", i ndryshuar, ju dërgojmë afatet për kryerjen e procedurave të lëvizjeve paralele në zbatim të tij, duke përcaktuar detyrat e zyrave vendore të arsimit parauniversitar (më tej ZVAP) dhe drejtorive rajonale (më tej DRAP), si më poshtë:

1. Më datë 10 gusht, DRAP përcjellin zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme, vendet e lira të punës për lëvizje paralele dhe gjatë vitit menjëherë nga njoftimi për vendin e lirë të punës.
2. ZVAP-të, në bashkëpunim me drejtoritë e institucioneve të arsimit parauniversitar (IAP-ve) publike, brenda datës 25 gusht, identifikojnë vendet e lira të punës që krijohen pas përfundimit të procesit të regjistrimit të nxënësve.
3. Për mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore, drejtori i IAP-së, brenda datës 25 gusht dërgon në ZVAP listën emërore, dokumentacioni e njësuar me origjinali dhe vlerësimin e dosjes, sipas shtojcës 2.1 të këtij udhëzimi.
4. Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve në ZVAP bën vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për lëvizje paralele sipas shtojcës 2.1 të këtij udhëzimi brenda datës 25 gusht.
5. Brenda datës 28 gusht ZVAP-ja bën shpalljen në faqen zyrtare dhe në stendat e informimit publik të listës së kandidatëve për lëvizje paralele, pas përfundimit të afatit 3 ditor të ankimimit.
6. Në periudhën 28-31 gusht, ZVAP-të kryejnë procedurat e lëvizjeve paralele sipas parashikimeve të kreut VII, "Procedurat për lëvizjet paralele", të udhëzimit Nr. 12.
7. Pasi kanë përfunduar procedurat për lëvizjet paralele, ZVAP-të shpallin në datë 1 shtator 2023, vendet e lira të punës për kandidatët e Portalit 2023-2024.
8. Lista e mësuesve të punësuar me procedurën e lëvizjes paralele, dërgohet në DRAP, brenda datës 1 shtator dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të ZVAP-së dhe në stendat e informimit publik. DRAP e publikon këtë listë në faqen e saj elektronike dhe e dërgon në DPAP, brenda datës 1 shtator.
9. Më 4 shtator, DRAP-i, pasi merr nga të gjitha ZVAP-të, listën me vendet e lira, me ngarkesë të plotë ose të pjesshme, për vitin shkollor në vijim e publikon në faqen e saj elektronike dhe e dërgon në DPAP brenda një dite pune sipas formateve të kërkuara.

10. Deri më 8 shtator, ZVAP-të bëjnë rakordimin sipas parashikimit të nevojave dhe numrit të miratuar të punonjësve, për të planifikuar numrin e mësuesve në dispozicion sipas fushave/profileve dhe publikon listën e kandidatëve të portalit që kanë zgjedhur të punësohen si mësues në dispozicion.
11. Nga data 5 shtator deri në një ditë para fillimit të vitit shkollor ZVAP-të vijojnë procedurat e punësimit në vendet e lira të punës të publikuara në faqen zyrtare, me kandidatë e portalit 2023-2024

*Faleminderit për bashkëpunimin.*

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Rezarta ALLA**

